



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 2 (827700)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 8 Janar 2021

Sot dua t'ju falenderoj të gjithëve!



FA janë një institucion që gëzon admirimin e shqiptarëve

Më kujtohet tre vite e pothuajse katër më parë, kur mu besua detyra e ministres së Mbrojtjes, flisja me Belën dhe Igli Hasanin në atë kohë, duke iu kërkuar të sillnin dosje e të më caktonin agjendën e takimeve, e këtë e atë, ata më thonin ta merrja pak më shtruar, sepse ishte vetëm java e parë e kishim kohë.

Por në fakt, kur je në një detyrë si kjo s'ke kurrë kohë. Koha që ke në dispozicion është shumë e shkurtër dhe fluturon me një shpejtësi të pabesueshme. Gjithë çfarë mund të bësh, gjithë çfarë DUHET të bësh, është të shfrytëzosh çdo ditë, çdo orë për të bërë diçka, për të realizuar sa më shumë nga projektet...

» faqe 2

NIKO PELESHI

Ministri i Mbrojtjes
i Republikës së Shqipërisë
2021-Jetëshkrimi



» faqe 3

Niko Peleshi në krye të Ministrisë së Mbrojtjes Ministri Peleshi: Objektivi im, një bazë ushtarake detare e NATO-s në Pashaliman

Në rrugëtimin tonë jemi përkrah aleatëve edhe unë dua të veçoj SHBA-në për ndihmën e vyer e të pakursyer që i japin Forcave tona të Armatosura » faqe 3



Aktivitetet u organizuan nga QKMBMMFA

Koncerte festive nga
fëmijët artistë për fëmijët
e ushtarakëve

Me rastin e festave të fundvitit, grupet e fëmijëve të ushtarakëve të cilët ndjekin kurset e muzikës: këngës, instrumentave muzikore, si kitarë, piano, apo pikturë, por edhe sporteve, etj. pranë Sektorit të Aktiviteteve me drejtues sektori, z.Gazment Caçi, në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura...



» faqe 6-7

VKM

Shpronësimi do të bëhet
në favor të Ministrisë së
Mbrojtjes

Qeveria më 24 dhjetor ka marrë vendimin "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e vendpreheve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941". Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10256, datë...

» faqe 5



STOLTENBERG NË CSU

Gjermania rol kryesor për
lidhjen transatlantike,
Amerikën e Veriut dhe Evropën

» faqe 8

GJENERALMAJOR, BAJRAM BEGAJ

Stërvitja "Defender 21", ndër më të
mëdhatë e realizuara në Shqipëri

» faqe 5

HISTORI

Bako Dervishaj nga ushtar
i thjeshtë në komandant korpusi

» faqe 15

SOT DUA T'JU FALENDEROJ TË GJITHËVE!

FA janë një institucion që gëzon admirimin e shqiptarëve

Fjala e dorëzimit të detyrës së ish-ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka



Më kujtohet tre vite e pothuajse katër më parë, kur mu besua detyra e ministres së Mbrojtjes, flisja me Belën dhe Igli Hasanin në atë kohë, duke iu kërkuar të më sillnin dosje e të më caktonin agjendën e takimeve, e këtë e atë, ata më thonin ta merrja pak më shtruar, sepse ishte vetëm java e parë e kishim kohë. Por në fakt, kur je në një detyrë si kjo s'ke kurrë kohë. Koha që ke në dispozicion është shumë e shkurtër dhe fluturon me një shpejtësi të pabesueshme. Gjithë çfarë mund të bësh, gjithë çfarë DUHET të bësh, është të shfrytëzosh çdo ditë, çdo orë për të bërë diçka, për të realizuar sa më shumë nga projektet që ke menduar apo ëndërruar, në mënyrë që kur të vijë dita për t'i dorëzuar stafetën një kolegu tjetër, të mund t'i njohësh vetes kënaqësinë se po i lë punët më mirë sesa i gjeje. Ose siç më thoshte një miku im, kur të vijë dita të largohesh të jesh e qetë që ke merituar një rresht në Muzeun e Forcave të Armatosura, që është një nga projektet që kisha më për zemër e që do të finalizohet shpejt, tanimë nën kujdesin e Nikos, jo sepse kam hallin e atij rreshtit, por sepse besoj që FA meritojnë të kenë një monument të tillë kujtese.

Forcat e Armatosura janë një institucion që kanë lindur bashkë me shtetin shqiptar. Janë një institucion që kanë një histori të jashtëzakonshme pas krahëve dhe, unë besoj, një të ardhur të ndritur përpara. Por për mua janë shumë më tepër se kaq. Sot ato janë familja ime, ku kam pasur mundësinë të kem jo thjesht kolegë e bashkëpunëtorë, por edhe shumë miq të mirë. Sot dua t'ju falënderoj të gjithëve! Çdo kuadro e çdo efektiv e çdo punonjës të kësaj ministrie! Sepse gjithë çfarë kemi bërë gjatë këtyre viteve e kemi bërë bashkë dhe do të kishte qenë e pamundur po mos kishim punuar bashkë. Por një falënderim nga zemra dua ta bëj për ta që kanë qenë realisht bashkëpunëtorët e mi më të afërt dhe njerëzit që kanë mbajtur peshën më të madhe të punëve të mira që kemi bërë në këto vite.

Dua të falënderoj shumë shefin e Shtabit, gjeneral Bajramin, që ka qenë një bashkëpunëtor i jashtëzakonshëm. I drejtë, reformator, eficient, një këshilltar shumë i mirë, e mbi të gjitha një njeri, që ia ka kushtuar jetën e karrierën FA-së dhe ndan vizionin për një forcë realisht moderne e profesionale. Bashkë me të, çdo gjeneral, komandantët e forcave, drejtorët e shtabit dhe çdo oficer me të cilët kemi punuar ngushtësisht për një reforme të gjithanshme, ligjore, institucionale e administrative.

Dua të falënderoj shumë Petro Koçin, kolegun e mikun e mirë, të përkushtuar e të papërtuar. Jam e bindur që Petro do të mbështesë po njësoj Nikon ashtu si edhe mua për modernizimin e FA. Flori, më vjen shumë keq që nuk do jesh më pjesë

e ekipit tim, pasi e di që e ke zemrën tek Mbrojtja; dikush më tha që Flori mbushi plot 20 vjet në Ministrinë e Mbrojtjes, ku do vazhdosh të jesh një aset i jashtëzakonshëm për Forcat e Armatosura. Të jam pafund mirënjohëse për punën dhe përkushtimin tënd! Për kabinetin kam një falënderim nga zemra për gjithë ditët pa orare, për gjithë javët pa fundjava, e për të gjithë vitet pa pushime që i keni dhënë kësaj pune. E dua t'i falënderoj po ashtu posaçërisht, që një pjese e tyre kanë zgjedhur të punojnë prapë pa orare e pa pushime me mua në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Singërisht, ndihem jo pak e trishtuar që po ndahem nga ju e nga kjo detyrë. Por ama ndihem mirë që së bashku ia kemi dalë të bëjmë aq shumë. Sepse besoj që kemi bërë punë vërtet të rëndësishme.

Sot, FA janë një institucion që gëzon respektin dhe admirimin e shqiptarëve. Në momentet më të vështira që kemi kaluar, që nga tërmeti tragjik i 26 Nëntorit, tek pandemia, apo zjarret, përmbajtjet e bllokimet nga dëborat e të tjera fatkeqësi natyrore, besoj qytetarët shqiptarë kishin sigurinë që nuk do të ishin kurrë vetëm. Që djemtë e vajzat, burrat e gratë me uniformë do të ishin aty pranë tyre për t'i ndihmuar. Me reformën ligjore e institucionale të emergjencave civile, me ngritjen e Agjencisë për Mbrojtjen Civile ia kemi dalë të japim një kontribut vërtet të madh për sigurinë e mirëqenien e qytetarëve shqiptarë nga fatkeqësitë e emergjencat.

Sot FA gëzojnë respektin dhe vlerësimin e partnerëve tanë ndërkombëtarë, sepse efektivët tanë nga Afganistani në Letoni e në Egje kanë shkëlqyer me punën dhe profesionalizmin e tyre.

Djemtë dhe vajzat tona në misione, meritojnë sot mirënjohjen tonë më të sinqertë për performancën e tyre që ka përforcuar imazhin e Shqipërisë jo thjesht si shtyllë stabiliteti në rajon, por si një eksportuese neto sigurie kudo që është thirrur të kontribuojë.

Të gjitha këto janë në fakt, veç provat e një transformimi të madh që ka filluar në FA. Dhe s'e kam fjalën këtu për pajisjet e infrastrukturën e mjetet, edhe pse edhe në këtë drejtim është bërë një punë e jashtëzakonshme. E kam mbi të gjitha fjalën për filozofinë e re që ka

mira në FA. Dhe jam e lumtur, që së bashku ia dolëm të përmirësojmë trajtimin financiar për efektivët e FA-së jo thjesht pse rritem pagat e ushtarakëve, apo sepse adresuam një padrejtësi të vitit 2013 e jo thjesht sepse ia dolëm të çojmë më shumë të ardhura në familjet e ushtarakëve, por edhe sepse të gjithë burrat e gratë në uniformë e meritojnë të trajtohen me më shumë dinjitet për shërbimi që i japin këtij vendi.

Sot, FA ka nisur të hedhë hapat e para drejt ringritjes së Forcës Ajrore

miste që me angazhimin e Nikos, do të realizohet me sukses edhe objektivi tjetër madhor që ne i kishim vënë vetes dhe në Shqipëri do të ketë së shpejti edhe një bazë detare të NATO në Pashaliman. Propozimi ynë për këtë bazë është pritur mjaft pozitivisht dhe edhe pse vendimmarrja lidhur me këtë bazë është shtyrë në kohë për shkak të pandemisë jam optimiste, që së shpejti edhe kjo bazë mund të bëhet realitet.

Të gjitha këto e sa e sa punë të tjera, i kemi bërë së bashku. Por, asnjë nga këto, nuk do të kishte qenë e mundur në qoftë se nuk do të kishim pasur në çdo hap mbështetjen e pakursyer dhe bujare të partnerëve tanë, ku sigurisht dua të veçoj e të falënderoj nga zemra, me shumë mirënjohje aleatët tanë amerikanë. Mbështetja e tyre në çdo fushë, nga Forca Ajrore e deri tek pajisjet e efektivëve tanë, nga Mbrojtja Kibernetike tek aprovimi i Bazës së Kuçovës, tek Emergjencat Civile ka qenë i jashtëzakonshëm. E me ta partneret tanë turq, italianë, grekë e britanikë për kontributin e paçmuar në arsimin dhe trajnimin e oficerëve dhe nënoficerëve tanë dhe modernizimin e forcave. Ne jemi me fat, jemi vërtet me fat që kemi miq kaq të mirë! Nuk dua të zgjatëm më shumë, sepse po të më lësh për Mbrojtjen mund të flas gjithë ditën. Por sot, jam e lumtur që stafetën ia kaloj një kolegu e një miku, të cilin realisht e respektoj për punën e vizionin dhe që jam e sigurt që do të jetë një drejtues efikas e punëmbarruar i këtij dikasteri ashtu siç ka qenë në çdo institucion që ka drejtuar.

5 Janar 2021



filluar të konsolidohet, atë të profesionalizmit e meritokracisë në FA.

Çelja e programit bachelor në Akademinë e FA, të certifikuar si institucioni i vetëm i arsimit të lartë në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, jam e bindur që do ta konsolidojë më shumë modelin e një force profesionale duke krijuar mundësinë për edukimin e kuadrove drejtuese por edhe thithjen e talenteve të më të

duke i shtuar flotës helikopterët Black Hawk, por duke filluar së shpejti punën me Lockheed Martin edhe për vëzhgimin e integruar të hapësirës ajrore. Dhe së shpejti, do të fillojnë punimet për ndërtimin e Bazës Ajrore të Kuçovës, e vetmja bazë e tillë në rajon, që do të transformojë rëndësinë strategjike të Shqipërisë.

Ndërkohë që, jam shumë opti-

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Hajrie **DEDAJ**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODO**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Niko Peleshi në krye të Ministrisë së Mbrojtjes

Ministri Peleshi: Objektivi im, një bazë ushtarake detare e NATO-s në Pashaliman

Në rrugëtimin tonë jemi përkrah aleatëve edhe unë dua të veçoj SHBA-në për ndihmën e vyer e të pakursyer që i japin Forcave tona të Armatosura

Pas dekretimit nga Presidenti i Republikës, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, zoti Ilir Meta, më datë 31 dhjetor 2020, pas miratimit nga Parlamenti më datë 4 janar 2021 dhe betimit para Presidentit në mbrëmjen e datës 4 janar 2020, z.Niko Peleshi, ditën e martë më 5 janar 2021, është ulur në karrigen e ministrit të Mbrojtjes. Z. Niko Peleshi mori detyrën e ministrit të Mbrojtjes nga paraardhësja e tij znj. Olta Xhaçka, e cila do të shërbejë në detyrën e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ministri i ri u prit ditën e martë, me 5 janar 2021, me ceremoni zyrtare nga Truproja e Nderit dhe Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura. Pas nderimit të Himnit të Flamurit, zonja Xhaçka falënderoi bashkëpunëtorët e saj gjatë drejtimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe vlerësoi reformat në vitet e fundit në Forcat e Armatosura. Nga ana e tij, ministri Peleshi vlerësoi kontributin e burrave dhe grave që shërbejnë në FA dhe bëri thirrje për të bashkuar forcat e të frymëzohemi nga e ardhmja evropiane e shqiptarëve, nga fëmijët tanë, për të çuar përpara misionin tonë për një Shqipëri të sigurt, demokratike e anëtare të denjë të BE-së. Në përfundim, zonja Xhaçka i prezantoi ministrit Peleshi drejtorët e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe komandantët e Forcave të Armatosura.

Në fjalën e tij me marrjen e detyrës, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se: “detyra e ministrit të Mbrojtjes është një përgjegjësi e veçantë ndaj atdheut tonë të dashur dhe popullit tonë”. Ai në vijim tha se: “Të përmbushësh me nder këtë përgjegjësi do të thotë t’i kontribuosh paqes, sigurisë dhe mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit; do të thotë të mbrosh dhe promovosh lirinë, vlerat qytetare demokratike dhe rendin tonë kushtetues si edhe të përmbushësh gjithnjë e më tepër, gjithnjë e më mirë detyrimet dhe rolin tonë si vend aleat i NATO-s. Ndihehmi i obliguar të justifikoj besimin që më dha kryeministri e mazhoranca, duke e kryer këtë detyrë me devocion dhe atdhedashuri.

Përsëritës me mirënjohje të gjithë djemtë e vajzat, burrat e gratë në uniformë, që janë asemi më i madh i Forcave të Armatosura. Viti i fundit ka qenë shumë i vështirë, por gjatë këtij viti sprove, që nga tërmeti e deri tek pandemia, ju keni ditur të tregoni që Forcat e Armatosura kanë sot një nivel profesionalizmi e modernizimi të admirueshëm, të denjë për një vend anëtar i NATO-s, aleancës më të fuqishme politike e ushtarake në botë.

Dua t’ju bëj një përsëritje të veçantë, të gjithë atyre efektivëve, rreth 200, që sot shërbejnë në misionet e NATO dhe BE, nga Afganistani në Kosovë e Afrikë, duke kontribuar në garantimin e sigurisë kolektive. Ata janë prova më e mirë e progresit që kanë bërë FA. Ata janë edhe kartëvizita më e mirë me të cilën Shqipëria prezantohet para aleatëve e partnerëve.

Sot përulëm me respektin më të madh para ushtarakëve, që dhanë jetën në krye të detyrës në misionet tona paqeruajtëse, si dhe i shpreh mirënjohjen më të veçantë familjarëve të

tyre. Në rrugëtimin tonë jemi përkrah aleatëve edhe unë ashtu si Olta dua të veçoj SHBA-në për ndihmën e vyer e të pakursyer që i japin Forcave tona të Armatosura. Dua t’i garantoj aleatët e partnerët tanë, që Shqipëria do të vazhdojë të jetë jo thjesht një faktor stabiliteti në rajon, por edhe një eksportues sigurie duke marrë pjesë në operacione ushtarake e humanitare kudo ku NATO, por edhe OKB dhe BE do të kenë nevojë për angazhimin tonë.

Edukimi dhe trajnimi i FA duhet të marrë një vëmendje të veçantë ndaj dua të vlerësoj sot si një arritje të shkëlqyer të ministres dhe bashkëpunëtorëve të saj në këtë ministri, hapjen e Akademisë së Forcave të Armatosura. Angazhohem t’i jap gjithë mbështetjen time rritjes dhe konsolidimit të këtij institucioni unik

të Arsimit të Lartë. Fillimi së afërmi i punimeve për Bazën e Kuçovës është një ngjarje me rëndësi të veçantë strategjike, por edhe një sfidë e jashtëzakonshme, që do të kërkojë dedikim maksimal nga të gjithë ne.



Jam gjithashtu në dijeni se ka filluar dialogu me NATO-n për Bazën e Pashalimanit. Ky projekt duhet ndjekur me këmbëngulje për ta kthyer në realitet. Ngritja e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile do të na bëjë më

të aftë për të përmbushur

përgjegjësinë e shtuar të Mbrojtjes Civile duke u përgjigjur më mirë, në kohë e me profesionalizëm para emergjencave civile për të garantuar jetën, mirëqenien dhe pasurinë e shqiptarëve.

Ky dikaster ka një të veçantë, sepse është tashmë i integruar plotësisht në strukturat euroatlantike. Është një institucion, performanca dhe puna e të cilit matet me standardet e NATO-s. Është bërë një punë jo e vogël për të na afruar sa më shumë me këto standarde. Por kemi ende punë për të bërë. Le të bashkojmë forcat e të frymëzohemi nga e ardhmja evropiane e shqiptarëve, nga fëmijët tanë, për të çuar përpara misionin tonë për një Shqipëri të sigurt, demokratike e anëtare të denjë të BE-së”.

ME DORËN MBI KUSHTETUTË

Ministri Niko Peleshi betohet para Presidentit Meta

Më datë 5 Janar 2021, në Institucionin e Presidentit të Republikës u zhvillua pasdite ceremonia e betimit të z.Niko Peleshi, Ministër i Mbrojtjes. Pas ekzekutimit të himnit kombëtar, Ministri Peleshi u betuan me dorën mbi Kushtetutë para

Kreut të Shtetit: “Betohehmi në nderin tim, se do të zbatoj me përpikëri Kushtetutën dhe ligjet, si dhe do të kryej me përgjegjësi detyrën shumë të rëndësishme që më është besuar, të anëtarit të Këshillit të Ministrave”. Presidenti i Republikës, Sh.T Z. Ilir Meta i dorëzoi dekretin përkatës të emërimit ministrit Peleshi, duke i uruar suksese

në detyrën e tij të re dhe të rëndësishme. Në ceremoninë e betimit ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i kryeministrit, z.Engjëll Agaçi si dhe anëtarë të Kabinetit të Presidentit.



NIKO PELESHI

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë 2021-Jetëshkrimi

Z. Niko Peleshi, prej datës 5 Janar 2021, mban funksionin e ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Niko Peleshi ka lindur në Korçë, më 11 nëntor 1970. Ka kryer studimet e larta për Inxhinieri Elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës me rezultate të shkëlqyera duke marrë titullin inxhinier elektronik. Në vitin 1989 ka përfunduar Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Raqi Qirinxhi” në Korçë me medalje të artë. Z. Peleshi ka pasur një angazhim të gjatë në fushën e biznesit privat në qytetin e Korçës: në vitet 2001 - 2004 ka drejtuar me sukses Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Korçë. Karriera politike e z. Peleshi fillon në tetor të vitit 2004, kur emërohet prefekt i qarkut Korçë dhe e ushtron këtë funksion për një vit. Në vitin 2005, zgjidhet kryetar i Partisë Socialiste të qytetit të Korçës. Në zgjedhjet lokale të shkurtit 2007 zgjidhet kryetar bashkie i Korçës, për t’u rikonfirmuar edhe njëherë si kryetar bashkie në zgjedhjet lokale të vitit 2011. Prej vitit 2012 është anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste. Prej shtatorit të vitit 2013 z. Peleshi emërohet zëvendëskryeministër, pozicion të cilin e mban deri në maj 2017. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, ai zgjidhet deputet në qarkun e Korçës duke kryesuar listën e Partisë Socialiste. Shtator 2017-janar 2019 mban postin e ministrit të Bujqësisë. Në janar 2021 emërohet ministër i Mbrojtjes. Z. Peleshi zotëron shumë mirë gjuhën angleze, si dhe flet rrjedhshëm gjermanisht dhe greqisht. Ai është i martuar dhe ka tre fëmijë.

SHQIPËRI-MALI I ZI

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes do të vazhdojë

Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi, Olivera Injac, zhvilloi në ditët e fundit të vitit që sapo u mbyll, më 29 dhjetor 2020, një takim online me ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, e cila tashmë ka marrë detyrën e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ministria Injac shprehu kënaqësinë për takimin online, duke theksuar se bashkëpunimi aktual midis Malit të Zi dhe Shqipërisë në të gjitha fushat është një shembull i marrëdhënieve miqësore të vazhdueshme midis dy vendeve fqinje. Ajo theksoi se gjatë mandatit të saj, bashkëpunimi midis dy vendeve aleate në fushën e mbrojtjes do të vazhdojë të jetë i suksesshëm dhe dinamik si në periudhën e mëparshme, veçanërisht në projektet brenda NATO-s. Injac gjithashtu iu referua bashkëpunimit thelbësor brenda

iniciativave rajonale, i cili kontribuon në forcimin e mëtejshëm të stabilitetit dhe sigurisë së Ballkanit Perëndimor.

Ndërkohë zonja, Olta Xhaçka, uroi ministrin Injac për inaugurimin e saj si ministre e Mbrojtjes së Malit të Zi, duke pritur që në periudhën e ardhshme bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në sektorin e mbrojtjes do të ketë mundësinë për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm, në përputhje me detyrimet, që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO. Gjatë takimit, ministrin Injac dhe Xhaçka gjithashtu iu referuan pandemisë së coronavirusit, e cila aktualisht është sfida më e madhe në nivelin global, dhe theksuan rëndësinë e solidaritetit dhe mbështetjes së ndërsjellë në luftën kundër kësaj sfide.



Vendim qeverie, 24 dhjetor 2020

Struktura dhe niveli i pagave për personelin mjekësor në FA...

Më datë 24 dhjetor 2020, Qeveria ka miratuar vendimin "Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Ushtarak të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura", të ndryshuar", kjo në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblyemeve", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave.

Kështu në vendimin nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon: "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës".

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon: "1. Në fushën e veprimt të këtij vendimi përfshihen: a) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë; b) personeli teknik i shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë; c) personeli mjekësor, punonjësit e tjerë civilë me arsim të lartë dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës; ç) personeli mjekësor ushtarak në strukturat e Forcave të Armatosura, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (roje, gatishmëri, urgjencë); d) personeli mjekësor civil dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes; dh) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes; e) personeli mjekësor dhe personeli teknik i shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës". c) Pika



2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Struktura dhe nivelet e pagave për: a) punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni", në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet rajonale, në spitalet psikiatrike dhe në spitalet bashkiake, janë sipas lidhjes nr.1/AP që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; b) personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; c) nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; ç) personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; d) personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; dh) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

e) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; ë) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; f) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; g) punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; gj) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; h) personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës, janë sipas lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e

tij; i) personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; j) personelin teknik të shkencave mjekësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes, si dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr.2 me kërret përkatës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

ç) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon: "3. Paga e grupit (kolona 1 e lidhjes nr.1 me kërret përkatës, kolona 1 e lidhjes nr.2 me kërret përkatës, kolona 3 e lidhjes nr.6, kolona 1, e lidhjes nr.7, kolona 1, e lidhjes nr.8 dhe kolona 1 e lidhjes nr.9), përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. d) Në fund të pikës 6 shtohen fjalët "... lidhjes nr.8 dhe lidhjes nr.9". dh) Në fund të pikës 7 shtohen fjalët "... lidhjes nr.5, lidhjes nr.6 dhe lidhjes nr.8". e) Pika 9/2 ndryshohet, me këtë përmbajtje: "9/2. Për punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore: a) kur punojnë brenda rrethit të tyre, por

larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 3 000 lekë në muaj. b) kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 4 000 lekë në muaj." . ë) Pas pikës 10 shtohen pikat 10/1 dhe 10/2, me këtë përmbajtje: "10/1. Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës që shërbejnë në institucionet shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është si vijon:

Kualifikimi/Grada/Titulli shken-cor Trajtimi financiar (Lekë në muaj) 1 Shef shërbimi Profesor, 75 000 2 Shef shërbimi Professor i asociuar 70 000 3 Shef shërbimi Doktor i shkencave 67 000 10/2. Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës që shërbejnë pranë Institutit të Shëndetit Publik, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është 70 000 lekë në muaj." . f) Pikat 15 dhe 15/1 shfuqizohen. 2. Në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime: a) Në lidhjen nr.6/6 emërtesa "Mjek në strukturat e Forcave të Armatosura" shfuqizohet. b) Në lidhjen nr.8/1 emërtesa "Mjek" shfuqizohet. 3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga fondet e miratuara për politikat e reja të pagave, në ligjin e buxhetit për vitin 2021. 4. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, në lidhjen II/4, emërtesat "Ndihmësmjek" dhe "Infermier" shfuqizohen.

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Bajram Begaj

Stërvitja "Defender 21", ndër më të mëdhatë e realizuara në Shqipëri

Zhvillohet analizat vjetore mbi punën e bërë nga komandat dhe njësitë kryesore të FARSH për vitin 2020

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në analizat vjetore të zhvilluara nga komandat e forcave dhe njësitë kryesore mbi punën e bërë nga ana e tyre gjatë vitit 2020. Analizat u zhvilluan ditën e mërkurë, më 6 janar 2021, nëpërmjet platformave online në kuadër të masave anti-COVID 19.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vlerësoi punën e bërë nga komandat e Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore, Komanda Mbështetëse, Akademia e Forcave të Armatosura dhe njësitë autonome, duke theksuar faktin se edhe pse ishte një vit i vështirë i kushtëzuar nga pandemia, FARSH ia dolën të realizojnë me sukses objektivat e vëna për vitin 2020.

Përveç përmbushjes së misionit kushtetues dhe ligjor, gjatë vitit 2020 Forcat e Armatosura luajtën një rol të rëndësishëm krahas institucioneve të tjera shtetërore në përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 si dhe në zbatimin e planit të masave kundër pandemisë. Gjithashtu, ato përmbushën me sukses detyrat në mbështetje të misioneve të NATO-s, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe iniciativave rajonale e koalicionëve ndërkombëtare. Flamuri shqiptar është valëvitur me krenari në Afganistan, Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, Letoni e deri në Sudanin e Jugut.

Gjithashtu, gjeneralmajor prof. asoc. Begaj u njoh me analizën e problematikës kryesore të hasur nga



komandat gjatë kryerjes së detyrave, mësimet e nxjerra, si dhe objektivat dhe prioritetet e planëzuara për rritjen e kapaciteteve operacionale për vitin 2021. Gjeneralmajor Begaj vuri theksin në stërvitjen shumëkombëshe "Defender

21", e cila do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të realizuara ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo stërvitje do të jetë një platformë ideale për rritjen e ndërvprueshmërisë si dhe testimin e kapaciteteve operacio-

nale të njësitë kryesore të FA.

Në përfundim të analizave, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj i uroi komandave suksese të mëtejshme për realizimin e objektivave për vitin 2021.

KOMANDA MBËSHTETËSE

Dy ura tip bailey për komunitetin në Memaliaj dhe në Pukë

Nga data 21 dhjetor deri më 1 janar, efektivat e Batalionit Xhenio të Komandës Mbështetëse kanë punuar pavarësisht kushteve të vështira të motit të stinës dhe i kanë dhuruar komunitetit në nevojë dy ura tip bailey duke punuar paralelisht në Memaliaj dhe në Pukë. Në bashkinë Memaliaj është ndërtuar ura prej 15 m seksion 2/1 me peshëmbajtje deri në 40 ton, në fshatin Arrëz e Madhe. Kjo urë lidh fshatrat Arrëz e Madhe, Arrëz e Vogël, Buz, Maricaj, dhe Vagalat me qendrën shëndetësore dhe shkollën 9 - vjeçare, si dhe me rrugën nacionale dhe Bashkinë Memaliaj. Ndërsa ura e dytë tip bailey ndërtuar në të njëjtën kohë ka një gjatësi prej 9 m, me një vlerë të jashtëzakonshme për lidhjen e transportin e këtij komuniteti.

VKM-VENDPREHJA E USHTARAKËVE GREKË

Shpronësimi do të bëhet në favor të Ministrisë së Mbrojtjes

Qeveria më 24 dhjetor ka marrë vendimin "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e vendpreshjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941". Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10256, datë 25.3.2010, "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941 dhe për ndërtimin e vendpreshjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë", të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr.742, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpreshjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.3.2010", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Infrastruktursë dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e vendpreshjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941", në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpreshjes për ta



brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.3.2010.

Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Mbrojtjes. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "truall", me vlerë 733 700 (shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e

shtatëqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 733 700 (shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekësh dhe shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga Ministria e Mbrojtjes.

Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur pranë Ministrisë së Mbrojtjes certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë së paluajtshme si dhe hartën treguese të regjistrimit.

Ministria e Mbrojtjes të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim. Afati i fillimit dhe mbarimit të punimeve të jetë në përputhje me parashikimet e projektit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Aktivitetet u organizuan nga QKMBMMFA me rastin e festave të fundvitit

Koncerte festive nga fëmijët artistë për fëmijët e ushtarakëve

Intervistë me regjisorin Saimir Braho, specialist në Sektorin e Aktiviteteve pranë QKMBMMFA

Me rastin e festave të fundvitit, grupet e fëmijëve të ushtarakëve të cilët ndjekin kurset e muzikës: këngës, instrumentave muzikore, si kitarë, piano, apo pikturë, por edhe sporteve, etj. pranë Sektorit të Aktiviteteve me drejtues sektori, z.Gazment Çaçi, në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, pergatitën dy programe muzikore për moshatarët e tyre, fëmijët e ushtarakëve.

Programi i parë artistik për fëmijët e ushtarakëve ishte një “Musical”, ku përmes vargjeve, tingujve dhe kërcimit, fëmijët kanë sjellë një atmosferë të gëzueshme. Koncerti u organizua pranë Muzeut të Forcave të Armatosura ku ishin të pranishëm shumë fëmijë të ushtarakëve, prindër, etj.

Kurse programi i dytë artistik u organizua me fëmijët e ushtarakëve në Komandën Mbeshtetëse. Në këto aktivitete ishin të pranishëm fëmijë, prindër, por edhe Zv.Ministri i Mbrojtjes. z.Petro Koci, Drejtore-sha e Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, znj.Mirela Roshi, etj.

Fëmijët sollën një atmosferë të ngrohtë, plot buzëqeshje në këto ditë të ftohta dimri dhe të vështira prej Covid-19 me shpresën se një vit më i mirë na pret përpara.

Të dy programet artistike si ai “Musical” ashtu dhe koncerti i fëmijëve u pergatitën nga specialistët e sektorit të aktiviteteve: regjisorin Saimir Braho, artistët e mirënjohur Kozma Dushi i cili përgatit kurset në kanto, Redon Makashi i cili përgatit kurset në kitarë, Denis Biraku i cili përgatit kurset në piano, por dhe Albina Ceka e cila përgatit kurset në pikturë.

Për më shumë detaje realizuam një intervistë me regjisorin Saimir Braho.

Sektorin e Aktiviteteve, pranë QKMBMMFA, organizoi në ambientet e Muzeut të Forcave të Armatosura, aktivitetin “Musical” me fëmijët e ushtarakëve, me rastin e festave të fundvitit, si ishte për ju të drejtonit aktivitetin?

Saimir Braho: Aktiviteti i kësaj here ishte i një forme tjetër i përkiste zhanrit artistik teatralo muzikor, ose ndryshe “musical”, ku janë të ndërthurura tri element kërcimi, këndimi dhe aktrimi. Fëmijët e qendrës së kulturës me këngën kishin pasur dhe me parë përvojë, kurse me aktrimin dhe kërcimin jo aq shumë. Na u desh të punonim në një kohë të shkurtër, por me fëmijët është gjithmonë avantazh, pasi ata thithin shumë shpejt janë si sfungjer dhe janë të gatshëm për bashkëpunim.



Si ishte të bashkëpunonit me fëmijë, po prindërit e tyre sa ju ndihmuan?

Saimir Braho: Unë kam vite që punoj me fëmijët, nëpër aktivitete artistike, në Akademinë e Arteve, në Teatër dhe në mënyrë private. Te punosh me fëmijët është një kënaqësi e veçantë dhe kënaqësia shumëfishohet kur shih prindër të gëzuar, ata janë treguar të gatshëm të sillnin dhe të merrnin fëmijët e tyre përditë. Por

gjeja më e rëndësishme është kur kjo të kthehet me mirënjohje.

A ka ndryshim mes aktivitetit të organizuar me fëmijët artistë të vegjël që ndjekin kurset pranë Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, dhe aktiviteteve të tjera artistike që keni zhvilluar, apo marrë pjesë?

Po ka ndryshim, është fakti që fëmijët që ndjekin kurset këtu ishin të

përgatitur nga ana artistike, në pjesën e këndimit kishin një lloj përvojë.

Covid-19 ka vështirësuar jetën e gjithsecilit prej nesh, sa e vështirë ishte për ju të punonit për të realizuar aktivitetin me fëmijët e ushtarakëve?

Saimir Braho: Në këtë situatë një nga gjerat që e ka të vështirë të realizohet është arti, ose më saktë arti kolektiv, pasi njerëzit duhet të

qëndrojnë bashkë, prandaj arti është shumë i penalizuar në këtë kohë. Mirëpo po të shohësh anën tjetër të medaljes njerëzit janë të etur për art si për ata që prodhojnë edhe për ata që e shijojnë. Njerëzit e marrin me shumë gëzim për ti parë shfaqjet në këtë situatë, pasi janë më të gatshëm për të shijuar, gjithmonë duke iu përmbajtur rregullave të distancimit social. Kurse fëmijët nga natyra e tyre nuk mund ti kuptojnë plotësisht vështirësitë që sjell kjo situatë.





A ju kanë ndihmuar eksperiencat tuaja artistike në realizimin e këtij “musical”?

Saimir Braho: Po sigurisht që po, nëse dikush nuk e ka këtë përvojë has probleme që në fillim, kurse kur ke përvojën ke parasysh rrugën që do të ndjekësh. Dhe komunikimi me njerëzit është sërish për shkak të përvojës, pasi kështu është më e lehtë të prodhosh atë që do. Urat e komunikimit janë të krijuara më përpara, kështu ti e di se çfarë kërkon.

Po institucioni ku ju punoni QKMBMFA çfarë përfaqëson për ju?

Saimir Braho: Përfaqëson një mundësi për ta provuar, për ta ushtruar këtë pasion, që kam në mënyrë të tillë



që të kem pikat e kontaktit në një zonë, në një ambient i cili është goxha i gjerë: bëhet fjalë për Forcat e Armatosura të cilat janë shumë dhe janë kudo, kështu në momentin që ti shërben në këtë institucion ke mundësi ta shprehësh atë, siç ishte dhe rasti i aktivitetit që realizuam. Nga ana tjetër është një sfidë që jam në këtë institucion, pasi kam mundësinë për të bërë disa aktivitete, që nuk janë bërë më parë.

Cili është urimi juaj për ush-tarakët tanë dhe gjithë shqiptarët?

Saimir Braho: Viti që do të vij shpresojmë të gjithë se nuk do të ketë probleme të tilla siç patëm në vitin që lamë pas, por dimë se do të ketë gjithmonë problem. Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes, ashtu siç kanë pasur çdo vit, do kenë gjithmonë sfida në aspektin e emergjencave civile. Unë uroj që ata këtë vit ta marrin me krah të lehta për të bërë atë që ata bëjnë çdo vit, të kenë zemër të fort dhe mendje të kthjellët, shëndet dhe mbarësi në familjet e tyre dhe mbi të gjitha paqe.

Përgatiti: Hajrie Dedaj



Stoltenberg në Unionit Social Kristian Gjerman (CSU)

Gjermania rol kryesor
për lidhjen transatlantike,
Amerikën e Veriut dhe Evropën*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në takimin e parlamentarëve të Bashkimit Social Kristian Gjerman, CSU (aktivitet në internet)*

Duke folur përpara fjalimit virtual para parlamentarëve të Unionit Social Kristian Gjerman (CSU) të mërkurën (6 janar 2021), Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg shpjegoi se 2021 do të jetë një vit vendimtar për NATO-n. Në një konferencë të përbashkët shtypi me Alexander Dobrindt, Kryetari i Grupit Parlamentar të CSU, Z. Stoltenberg vlerësoi forcat e armatosura aleate për mbështetjen e përpjekjeve civile për të përballuar pandeminë COVID-19. Sekretari i Përgjithshëm theksoi gjithashtu se ky vit do të jetë një mundësi e rëndësishme për të ri-aktivizuar marrëdhëniet transatlantike dhe për të forcuar më tej lidhjen midis Evropës dhe Amerikës së Veriut: “Kështu që ne duhet të qëndrojmë së bashku, Amerika e Veriut dhe Evropa, dhe unë me të vërtetë i besoj Gjermanisë, ajo është duke luajtur një rol kryesor në këto përpjekje”. Z. Stoltenberg gjithashtu bëri të qartë se 2021 do të jetë një vit i vendimeve për Afganistanin. Ai mirëpriti bisedimet e paqes në vazhdim: “Ka shumë sfida dhe shumë pasiguri, por natyrisht, bisedimet e paqes janë rruga e vetme drejt paqes, e vetmja rrugë përpara për një zgjidhje paqësore të negociuar. Ne i mbështesim ato përpjekje”. Z. Stoltenberg shtoi se ministrat e Mbrojtjes së NATO-s do të vlerësojnë të ardhmen e misionit të NATO-s në Afganistan në shkurt. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu deklaroi se 2021 do të jetë një vit i rëndësishëm për kontrollin e armëve dhe mos-përhapjen e armëve. Ai tha: “Ne duhet të sigurohemi kur marrëveshja e re START skadon muajin tjetër që të mos përfundojmë me një situatë ku nuk ka marrëveshje që rregullon numrin e kokat bërthamore”.

Gjermania rol kryesor në lidhjen transatlantike, Amerikën e Veriut dhe Evropën

Deklarata nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në konferencën e përbashkët për shtyp me Alexander Dobrindt, Kryetari i Grupit Parlamentar të CSU

“Është një kënaqësi dhe nder i madh që u njoha dhe iu takova të gjithëve sot. Kjo është hera e dytë që marr pjesë në Klausurtagung, të organizuar nga CSU dhe për mua, që pasqyron angazhimin e fortë të CSU për lidhjen transatlantike dhe për NATO-n.

Sigurisht që do të kisha preferuar të takohesha personal-

isht, por të gjithë e kuptojmë se pandemia COVID-19 e bën atë të pamundur. Në të njëjtën kohë unë gjithashtu besoj se 2021 është një vit ku të gjithë kemi shpresë se do të jemi në gjendje të kthejmë qoshen në luftën kundër pandemisë dhe forcat tona ushtarake, aleatët e NATO-s, NATO sigurojnë mbështetje për përpjekjet civile, duke u përpjekur të përballen me pandeminë.

Unë jam gjithashtu jashtëzakonisht mirënjohës për mbështetjen e fortë të CSU-ve për NATO-n, jo më shumë sepse ne jetojmë në një botë me sfida dhe më të paqëndrueshme dhe pastaj kemi nevojë për parandalim të fortë, mbrojtje të fortë dhe rolin kryesor të Gjermanisë në sigurimin e kësaj përmes NATO-s.

2021 do të jetë një vit i rëndësishëm, jo vetëm në luftën kundër pandemisë. Por gjithashtu, kur përballemi me sfida të ndryshme të sigurisë. Unë fuqimisht besoj se 2021 do të jetë thelbësore në një mënyrë që do të na sigurojë një mundësi për të rienergizuar lidhjen tonë transatlantike, bashkëpunimin midis Amerikës së Ver-

iut dhe Evropës. Dhe se kjo është koha për të investuar më shumë në lidhjen tonë transatlantike për të kuptuar rëndësinë e ndarjes së drejtë të barrës. Unë mirëpres rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes nga Gjermania dhe angazhimin për të përmbushur objektivin 2%, udhëzimin e shpenzimit të 2% të PBB-së në mbrojtje.

Çdo përpjekje për të ndarë Evropën dhe Amerikën e Veriut jo vetëm që do të dobësojë lidhjen transatlantike ose do të dobësojë NATO-n, por gjithashtu do të ndajë Evropën, kështu që ne duhet të qëndrojmë së bashku, Amerika e Veriut dhe Evropa, dhe unë me të vërtetë besoj se Gjermania luan rolin kryesor në këto përpjekje.

Pastaj, 2021 gjithashtu është një vit i rëndësishëm për NATO-n sepse ne duhet të vendosim për praninë tonë në Afganistan. Ne i mirëpresim bisedimet e paqes që zhvillohen midis Talibanëve dhe qeverisë në Kabul. Ka shumë sfida dhe shumë pasiguri, por natyrisht, bisedimet e paqes janë rruga e vetme drejt paqes, e vetmja rrugë përpara për një zgjidhje të negociuar paqësore.

Ne i mbështesim ato përpjekje, por në të njëjtën kohë e dimë se do të ballafaqohemi me një dilemë shumë të vështirë.

Muajin tjetër, ministrat e Mbrojtjes së NATO-s do të takohen dhe ata duhet të vendosin nëse do të qëndrojnë, nëse do të qëndrojmë në Afganistan me praninë tonë ushtarake, dhe pastaj rrezikojnë të angazhohen në një prani të zgjatur ushtarake në Afganistan, ose nëse do të largohen, por më pas rrezikojnë që Afganistani përsëri bëhet një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë.

Muajin tjetër, skadon marrëveshja e re START e cila kufizon numrin e kokat bërthamore. “NATO ka qenë gjithmonë në ballë të kontrollit të armëve duke luftuar për kontroll të fortë dhe të ekuilibruar të armëve dhe çarmatimin, dhe për këtë arsye ne duhet të sigurohemi që ne, kur marrëveshja e re START të skadojë muajin tjetër, që të mos përfundojmë në një situatë ku nuk ka ndonjë marrëveshje që rregullon numrin e kokat bërthamore.

Ka shumë çështje të tjera duke përfshirë internetin, luftën kundër terrorizmit dhe shumë prej çështjeve me të cilat do të ballafaqohet NATO.

Mesazhi im kryesor është se kur bëhet fjalë për të gjitha këto çështje, për sa kohë që Amerika e Veriut dhe Evropa qëndrojnë së bashku, Gjermania duke qenë një pjesë e rëndësishme e kësaj, natyrisht CSU duke qenë një lojtar i rëndësishëm në Gjermani, ne do të jemi në gjendje të trajtojmë dhe trajtojmë të gjitha sfidat me të cilat përballemi. Edhe një herë, ju falënderoj shumë, Kryetar, që më keni. Unë pres që të takohem me parlamentarët menjëherë pas këtij takimi për shtyp.

Pyetje: Sekretar i Përgjithshëm ju tashmë keni përmendur Afganistanin, që vendimi pro ose kundër tërheqjes do të pritët në shkurt dhe ju folët më parë për vendimin e bazuar në kushte. Cilin nga ato kushte keni parasysh dhe cilat nga ato janë përmbushur tashmë?

Sekretari i Përgjithshëm: Gjëja më e rëndësishme është që ne duhet të sigurohemi që Afganistani të mos bëhet përsëri një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë.

Ne duhet ta kuptojmë se arsyeja pse kemi hyrë në Afganistan gati 20 vjet më parë ishte sulmi ndaj një aleati të NATO-s, 11 shtatori kundër Shteteve të Bashkuara dhe Talibanët janë zotuar që në marrëveshjen me Shtetet e Bashkuara të bëjnë të sigurt se nuk punojnë me ta, nuk mbështesin, nuk ndihmojnë në asnjë mënyrë të sigurojnë ndonjë mbështetje kornizë për terroristët ndërkombëtarë. Prandaj, kushti më i rëndësishëm është të sigurohemi që Talibanët të përmbushin atë kërkesë, që ata të prishin të gjitha lidhjet me ndërkombëtarët

STOLTEBERG LIDHUR ME NGJARJET NË AMERIKË

